



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni Rregullator

Data: 18.4.2023

Nr: 18

Ora: 14:30

VENDIM

PËR

**PËRDORIMIN E KAMERAVE REGJISTRUESE DHE TË MONITORËVE PËR SHFAQJEN
E FLETËVE TË VOTIMIT NË VENDET E NUMËRIMIT TË VOTAVE,
NË ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të Dekretit të Presidentit nr. 13864, datë 24.10.2022, "Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore", të nenit 20, pika 2, shkronja "c", nenit 22, pika 2, nenit 23, pika 1, nenit 94, pika 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

VENDOSI:

1. Përdorimin e kamerave regjistruese dhe të monitorëve (ekraneve), për regjistrimin dhe shfaqjen e fletëve të votimit, në çdo vend të numërimit të votave, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.
2. Përdorimin e sistemit të transmetimit video në kohë reale të monitorimit të numërimit të votave nga çdo vend i numërimit të votave, në ambientet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.
3. Përdorimi i kamerave regjistruese e monitorëve (ekraneve) dhe sistemi i transmetimit video në kohë reale nga çdo vend i numërimit të votave, në ambientet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, do të bëhet në bazë të rregullave procedurale të miratuara me akt normativ të Komisionit Rregullator.
4. Ngarkohet administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Data: 18.4.2023 Nr: 18
Ora: 14:30



"Për përdorimin e kamerave regjistruese dhe të monitorëve për shfaqjen e fletëve të votimit në vendet e numërimit të votave, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023".

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Ilirjana NANO	Kryetar
Arens ÇELA	Anëtar
Dritan ÇAKA	Anëtar
Helga VUKAJ	Anëtar
Muharrem ÇAKAJ	Anëtar